



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2727 / prot.

Elbasan, më 27.11.2025

VENDIM

Nr. 75 datë 27.11.2025

"Për

**hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në
"Shëndet Mendor"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 2; neni 35, pika 1; neni 38 pika 1, gërma "dh"; neni 81; Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL", Kreu IV, germa "A", i ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" neni 9, gërma "gj", me propozim të Departamentit të Specialiteteve Tekniko Mjekësore në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në "Shëndet Mendor", në Departamentin e Specialiteteve Tekniko Mjekësore në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në bashkërendim me Fakultetin e Shëndetit në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë Akt - Marrëveshjen "Për grupimin e njësive bazë/kryesore për bashkërendimin e veprimtarive dhe përgjegjësisë për organizimin dhe realizimin e programit të studimit master shkencor në "Shëndet Mendor", midis Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, sipas tekstit që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Të miratojë listën e personelit akademik për realizimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në "Shëndet Mendor", sipas shtojcës 1 që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Vendimi i Senatit Akademik t'i përcillet Bordit të Administrimit për procedurë të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Elvira Fetahu





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Shtojca 1

Lista e personelit akademik për realizimin e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë
Master Shkencor në "Shëndet Mendor"

1. Prof.Dr. Skënder Topi – Metodologjia e kërkimit shkencor në kujdesin shëndetësor.
2. Prof.as.dr Gazment Koduzi – Lidership, planifikim dhe menaxhim në kujdesin shëndetësor ndaj shëndetit mendor.
3. Prof.as.dr. Brunilda Elezi – Bazat e kujdesit dhe praktikës në shëndetin mendor. Parime dhe koncepte të përgjithshme.
4. Prof.as.dr. Gjergji Koja – Politikat shëndetësore për ndërhyrje efektive në shëndetin mendor.
5. Prof.as.dr. Elona Gaxhja – Etika, vlerat profesionale dhe komunikimi terapeutik në kujdesin ndaj shëndetit mendor.
6. Dr. Mitilda Gugu – Menaxhimi medikamentoz dhe aderenca ndaj terapisë në shëndetin mendor.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. ____ Prot. Vlorë, më __. __. 2025

Nr. 2727/2 Prot. Elbasan, më 27.11.2025

Universiteti i Vlorës
“Ismail Qemali”

Universiteti i Elbasanit
“Aleksandër Xhuvani”

AKT-MARRËVESHJE

PËR

GRUPIMIN E NJËSIVE BAZË/KYESORE PËR BASHKËRENDIMIN E VEPRIMTARIVE DHE PËRGJEGJËSIVE PËR ORGANIZIMIN DHE REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER SHKENCOR NË “SHËNDET MENDOR”

Në respekt e në zbatim të detyrimeve të parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 në Statutin e Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, udhëzimin nr. 7, datë 31.3.2021 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar”, VKM-në nr. 185, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar”, VKM-në nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, Fakulteti i Shëndetit në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj, Rektore e Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali” dhe Prof. Dr. Elvira Fetahu Rektore e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, marrin përsipër të nënshkruajnë këtë akt-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

marrëveshje ndërveprimi për bashkërendimin e veprimtarive, procedurave, rolit dhe përgjegjësisive për organizimin dhe realizimin e programite studimit Master Shkencor në “Shëndet Mendor:

NENI 1 QËLLIMI

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i detyrimeve dhe të drejtave të dy Universiteteve në ofrimin e programit të studimit Master Shkencor në “Shëndet Mendor”.

NENI 2 MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT

1. Fakulteti i Shëndetit në Universitetin “Ismail Qemali”, do të zhvilloj të gjitha procedurat në aplikimin e këtij programi studimi pranë MAS
2. Çdo institucion Partner do të emërojë një Koordinator Programi. Koordinatorët e Programit do të formojnë Bordin e Menaxhimit të Programit. Bordi i Menaxhimit të Programit është përgjegjës për monitorimin e përgjithshëm të zbatimit të Programit të Përbashkët Master Shkencor në “Shëndet Mendor”. Për të nxitur bashkëpunimin dhe përfshirjen, Bordi i Menaxhimit të Programit do të përdorë një qasje vendimmarrëse me konsensus. Një Koordinator i Bordit të Menaxhimit të Programit do të zgjidhet nga anëtarët e tij për çdo vit akademik, me koordinatoren për vitin pasardhës të zgjedhur nga institucioni tjetër Partner. Bordi i Menaxhimit të Programit do t'u raportojë drejtuesve përkatës të institucioneve (drejtuesve të departamenteve, dekanëve dhe rektorëve).
3. Komisionet e provimeve do të emërohen nga Bordi i Menaxhimit të Programit për çdo kurs/lëndë në fillim të semestrit. Komiteti i provimeve për çdo kurs/lëndë do të përbëhet nga të paktën dy anëtarë nga secili institucion Partner. Komisionet e provimeve do të jenë përgjegjëse për monitorimin e procesit të provimeve për studentët.

NENI 3 KURRIKULA E PROGRAMIT

1. Kurrikula e Programit paraqitet në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje, e cila përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.



2. Kurrikula mund të jetë subjekt i ndryshimeve për shkak të ndryshimeve në ofertën akademike dhe në përputhje me rregullat ligjore dhe institucionale të institucioneve përkatëse. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim dhe të miratohet nga të të dy institucionet partnere në përputhje me rregulloret e tyre.

NENI 4 PRANIMI I STUDENTËVE

1. Numri i studentëve që marrin pjesë në Programin e studimit do të përcaktohet çdo vit nga secili universitet partner në përputhje me politikat e tyre individuale dhe kapacitetet pritëse. Institucionet partnere duhet të përpiqen të mbajnë një ekuilibër të arsyeshëm në numrin e studentëve.
2. Pranimi i studentëve kryhet veçmas nga secili institucion Partner, sipas rregulloreve të tyre institucionale për programet e përbashkëta. Kërkesat minimale për të dy institucionet përfshijnë:
 - a) Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses programin universitar (bachelor) me minimum 180 ECTS në një fushë të ngjashme paraardhëse (Mjekësi, Infermieri, Shëndet Publik, si dhe programe të tjera të fushës së shëndetësisë).
 - b) Studentët duhet të paraqesin dokument për njohuritë e tyre në një nga pesë (5) gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian), sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
3. Koordinator i Programit të secilit universitet do të informojë institucionet Partnere për studentët e përzgjedhur menjëherë pasi të ketë përfunduar procesi i përzgjedhjes.
4. Informacion dhe dokumente shtesë do të ofrohen nga secila palë për të përfunduar procesin e pranimi dhe regjistrimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 5 REGJISTRIMI I STUDENTËVE, NJOHJA DHE TRANSFERIMI I KREDITEVE

1. Regjistrimi i studentëve do të rregullohet nga rregulloret institucionale të secilit institucion Partner. Çdo institucion Partner do të mbajë të dhëna të sakta të të gjithë studentëve të regjistruar në Programin e studimit dhe do t'u ofrojë të gjithë studentëve dhe institucioneve Partnere transkripte zyrtare të të dhënave, duke specifikuar aktivitetet që janë përfunduar.



2. Në rastin e krediteve të fituara nga një student në studimet e mëparshme master që janë të ngjashme ose ekuivalente me programin e studimit Master Shkencor në “Shëndet Mendor”, një komision në nivel Institucioni do të kryejë një vlerësim për të përcaktuar të drejtën e tyre për njohje. Rezultatet e vlerësimit do t'i komunikohen Bordit të Menaxhimit të Programit. Në fund, njohja dhe transferimi i krediteve do të kryhen në përputhje me rregulloret institucionale.

NENI 6

DETYRIMET E STUDENTËVE PËR KURSIN/LËNDËN DHE LËVIZSHMËRIA NDËRINSTITUCIONALE

1. Studentët e regjistruar në Programin e studimit Master Shkencor në “Shëndet Mendor” në universitetin Partner do të ndjekin mësimet brenda ambienteve të tij.
2. Leksioni do të zhvillohet në një nga Institucionet ku pedagogu respektiv dhe studentët do të jenë në klasë ndërsa studentët e Institucionit partner do të jenë dhe ata në klasë duke ndjekur leksionin.
3. Studentët e regjistruar në Programin e studimit Master Shkencor në “Shëndet Mendor” në universitetin partner duhet ta japin provimin brenda ambienteve të tij.
4. Aktivitetet e përbashkëta do të organizohen me pjesëmarrjen e të gjithë studentëve nga të dy universitetet. Aktivitetet do të organizohen nga Bordi i Menaxhimit të Programit dhe do të jenë në përputhje me kurrikulën. Studentët do të njoftohen për aktivitetet në kohën e duhur dhe pjesëmarrja e tyre do të jetë e detyrueshme.

NENI 7

VLERËSIMI I STUDENTËVE

1. Suksesi i studentëve në programin master dhe të gjitha format e vlerësimit të njohurive para provimeve vlerësohet dhe shprehet në pikë. Studentët grumbullojnë në mënyrë kumulative pikë nga të gjitha vlerësimet e njohurive. Bazuar në të gjitha format e vlerësimit të njohurive para provimit, ose rezultatet e të nxënit, dhe duke dhënë provimin, studentët mund të arrijnë një maksimum prej 100 pikësh ose të notës dhjetë (10).
2. Nota mesatare gjatë studimeve përcaktohet si herësi i shumës së produktit të notës numerike dhe krediteve ECTS për secilën lëndë dhe numrit të përgjithshëm të krediteve ECTS të fituara.



3. Nota përfundimtare, me një maksimum prej 100 pikësh, përcaktohet sipas shkallës së mëposhtme:

- a. Nota 10: 90 – 100 pikë;
- b. Nota 9: 80 – 89 pikë;
- c. Nota 8: 70-79 pikë;
- d. Nota 7: 60 – 69 pikë;
- e. Nota 6: 50 – 59 pikë;
- f. Nota 5: 40 – 49 pikë;
- g. Nota 5: 0 – 39 pikë.

NENI 8 PROVIMI I STUDENTËVE

1. Pedagogu i lëndës ose komisionet e provimeve për secilin kurs/lëndë janë përgjegjëse për monitorimin e procesit të provimeve të studentëve si dhe për vlerësimin e tyre.
2. Periudhat e provimeve përfundimtare organizohen pasi të jenë përfunduar leksionet dhe para përfundimit të çdo semestri. Periudha shtesë e provimeve mund të organizohet në shtator, në përputhje me legjislacionin institucional/kombëtar.

NENI 9 TARIFA E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT

1. Studentët do të duhet të paguajnë tarifat e regjistrimit dhe të shkollimit në universitetin e tyre përkatës të origjinës. Tarifat për Master Shkencor në “Shëndet Mendor” do të përcaktohen nga secili universitet partner, në përputhje me rregulloret e tyre dhe rregulloret e rëna dakord për programin.

NENI 10 DIPLOMIMI

1. Pas përfundimit me sukses të Programit Master Shkencor në “Shëndet Mendor”, studentëve do t'u jepet një diplomë Masteri i Shkencave (MSc.) që përbëhet nga 120 kredite ECTS. Kjo diplomë do t'u ofrojë atyre mundësinë për të ndjekur arsimim të mëtejshëm në një Program Doktorature, nëse dëshirojnë ta bëjnë këtë.



2. Diploma e Programit Master Shkencor në “Shëndet Mendor” do të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të dy institucioneve partnere.
3. Diploma e Programit Master Shkencor në “Shëndet Mendor” do të përfshijë suplementin e diplomës (sipas Nenit IX.3 të Konventës së Njohjes së Lisbonës nga 11 Prilli 1997).

NENI 11

TEZA E DIPLOMËS MASTER

1. Studentët duhet të zbatojnë rregulloret e institucionit ku ndjekin studimet në lidhje me përgatitjen, vlerësimin, provimin dhe procedurat e tjera përkatëse të tezës së diplomës Master Shkencor në “Shëndet Mendor”.
2. Teza e diplomës master duhet të përgatitet në shqip dhe një kopje duhet t'i dorëzohet institucionit partner.
3. Mbrojtja e tezës së diplomës master do të zhvillohet në ambientet e universitetit partner ku studenti është regjistruar.
4. Komisioni për provimin e tezës së diplomës master do të përbëhet nga të paktën tre akademikë, njëri prej të cilëve duhet të jetë nga institucioni partner.
5. Institucionet Partnere bien dakord të njohin reciprokisht tezat e përfunduara në universitetin Partner, të pranojnë rezultatet e provimeve dhe notat e dhëna.

NENI 12

KONVERTIMI I NOTAVE

1. Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve (ECTS) do të përdoret për vlerësimin e rezultateve të çdo provimi dhe notën përfundimtare.

NENI 13

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E STUDENTËVE

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve rregullohen nga rregulloret e institucioneve Partnere dhe legjislacionit kombëtar.



2. Çdo student do të regjistrohet në institucionin e tij të origjinës.
3. Studentët kanë të drejtë për akses të plotë në të gjitha mjediset e institucionit partner, duke përfshirë bibliotekat online, laboratorët dhe burimet e tjera akademike, gjatë periudhës së studimit të tyre.

NENI 14

KOHËZGJATJA DHE RINOVIMI I MARRËVESHJES

1. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të fundit nga të dy institucionet Partnere.
2. Marrëveshja ka një kohëzgjatje prej 5 vitesh, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj. Marrëveshja rinovohet automatikisht për një periudhë pasuese prej 5 vitesh, përveç nëse një nga institucionet Partnere jep njoftim me shkrim për përfundimin të paktën 6 muaj para skadimit të afatit aktual.
3. Në rast të përfundimit të Marrëveshjes, kjo nuk do të ndikojë në diplomimin e studentëve në vazhdimësinë e yre që janë regjistruar tashmë para datës efektive të përfundimit. Për më tepër, përfundimi nuk do të modifikojë asnjë detyrim që duhet të përmbushet për studentët e semestrit aktual, studimet të cilët janë ende në vazhdim.
4. Ndryshimet në Marrëveshje do të bëhen me shkrim dhe do të nënshkruhen nga të dy institucionet Partnere. Çdo ndryshim hyn në fuqi në datën e specifikuar në ndryshim, ose në mungesë të një specifikimi të tillë, në datën e nënshkrimit të saj.

NENI 15

RREGULLA PËRFUNDIMTARE

1. Çdo çështje që nuk përfshihet në këtë Marrëveshje do të rregullohet nga rregulloret e brendshme ose legjislacioni kombëtar.
2. Në rast mosmarrëveshjeje, institucionet partnere do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur një zgjidhje miqësore. Nëse këto përpjekje dështojnë, mosmarrëveshja do t'i referohet një pale të tretë të dakorduar për zgjidhje.
3. Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në katër kopje origjinale, ku secila palë do të marrë dy kopje origjinale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4. Çdo ndryshim ose modifikim i kësaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim dhe i nënshkruar nga të dy palët.

PROF. DR. AURELA SALIAJ

**REKTOR
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË**

PROF. DR. ELVIRA FETAHU



**REKTOR
UNIVERSITETI I ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"**



Aneksi I

Kurrikula e programit të studimit

Ndarja e moduleve sipas veprimtarive formuese				
		Kodi	Lënda	Kreditet
Lëndë bazë: A (5%–10%) 10 kredite	1		Bazat e kujdesit dhe praktikës në shëndetin mendor. Parime dhe koncepte të përgjithshme.	2
	2		Metodologjia e kërkimit shkencor në kujdesin shëndetësor.	6
	3		Lidership, planifikim dhe menaxhim në kujdesin ndaj shëndetit mendor.	2
Lëndë karakterizuese: B (50%–60%) (60 kredite)	4		Vlerësimi klinik dhe Vendimarrja në kujdesin e shëndetit mendor.	8
	5		Kujdesi i avancuar për shëndetin mendor I	10
	6		Kujdesi i avancuar për shëndetin mendor II	10
	7		Edukim, promocion dhe vetkujdesje në shëndetin mendor.	8
	8		Menaxhimi i urgjencave psikiatrike dhe abuzimeve	10
	9		Epidemiologjia	6
	10		Menaxhimi medikamentoz dhe aderenca ndaj terapisë në shëndetin mendor.	8
Lëndë ndërdisiplinore / integruese: C (12%–20%)	11		Etika, vlerat profesionale dhe komunikimi terapeutik në kujdesin ndaj shëndetit mendor.	4
	12		Emergjencat shëndetësore	6



(20 kredite)	13		Kujdesi psikosocial dhe okupacional në shëndetin mendor.	4
	14		Politikat shëndetësore për ndërhyrje efektive në shëndetin mendor.	4
	15		Shëndeti dixhital dhe telemedicina për çështjet e shëndetit mendor.	2
			Gjuhë e huaj profesionale	
		Sipërmarrja në kujdesin shëndetësor		
Lëndë plotësuese D (10%)	16		Praktikë profesionale I	6
(12 kredite)	17		Praktikë profesionale II	6
Detyrimet përmbyllëse: E (10%–15%)	18		Temë Diplome	18
18 kredite				
Totali				120



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Aneksi II

Plani mësimor në "Master i Shkencave në "Shëndet Mendor", viti akademik 2026-2028

Viti akademik	Semestri	Kodi	Lënda	Kredite	Totali orë / semestër brenda & jashtë auditorit	Totali orë/ semestër në auditor	Totali orë/ semestër studim individual	Totali orë / semestër në auditor							
								Leksione	Seminare	Ushtrime	Projekte	Laboratore	Praktika		
Viti I	Sem. I		Bazat e kujdesit dhe praktikës në shëndetin mendor. Parime dhe koncepte të përgjithshme.	2	50	30	20	15	15	0	0	0	0	0	0
			Vlerësimi klinik dhe vendimmarrja në kujdesin e shëndetit mendor.	8	200	110	90	30	0	0	5	15	60		
			Kujdesi i avancuar për shëndetin mendor I.	10	250	105	145	45	0	0	0	60			
			Etika, vlerat profesionale dhe komunikimi terapeutik në kujdesin ndaj shëndetit mendor.	4	100	50	50	30	15	5	0	0	0		
			Epidemiologjia	6	150	65	85	45	15	0	5	0	0		
TOTALI SEM. I				30	750	360	390	165	45	5	10	15	120		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



	Metodologjia e kërkimit shkencor në kujdesin shëndetësor.	6	150	95	55	45	10	0	10	0	30
	Zgjidh 1 (një) nga:										
	Shëndeti dixhital dhe telemedicina për çështjet e shëndetit mendor	2	50	30	20	15	0	5	0	10	0
	Gjuhë e huaj profesionale										
	Sipërmarrja në kujdesin shëndetësor										
	TOTALI SEM. I	30	750	385	365	165	40	5	15	10	150
Sem. II	Emergjencat shëndetësore	6	150	65	85	30	15	0	5	15	0
	Praktikë profesionale II	6	150	150	0	0	0	0	0	0	150
	Temë Diplome	18	450	0	450	0	0	0	0	0	0
	TOTALI SEM. II	30	750	215	535	30	15	0	5	15	150
	TOTALI VITI II	60	1500	600	900	195	55	5	20	25	300
	TOTALI I GJITHË PROGRAMIT	120	3000	1380	1620	465	145	10	45	55	660